



VENDIMI ËSHTË I PLOTËFUQISHËM
 ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA
 GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
 FERIZAJ / UROŠEVAC

Me
 Data 11-06-2018

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI I PËRGGJITHSHËM – DIVIZIONI PENAL, me Gjyqtarin e vetëm gjykues Mustaf Tahiri dhe sekretaren juridike Drita Ujupi në lëndën penale kundër të akuzuarve [REDACTED] dhe [REDACTED] për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale vjedhje nga neni 325 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.1520-7/16 të datës 21 prill 2017, aktakuzës PP/II.nr.746-1/15 e dt.16 nëntor 2015 të akuzuarit [REDACTED] dhe [REDACTED] akuzohen se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 nënpar.1.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, aktakuzës 1024-4/16 të datës 27.04.2017 i akuzuari [REDACTED] akuzohet se ka kryer veprën penale vjedhje nga neni 325 par.1 të KPRK-së, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor në prani të prokurorit të shtetit Mimoza Sylja, të akuzuarve, mbrojtësit të akuzuarit [REDACTED] av. [REDACTED] [REDACTED] me dt: 23.04.2018, shpall dhe publikisht komunikoi, ndërsa me datë 02.05.2018, përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

Ndaj të akuzuarve,

1. [REDACTED] nga fshati [REDACTED] K.Ferizaj, i lindur me [REDACTED] në Gjilan, nga i ati [REDACTED] dhe e ëma [REDACTED] e gjinisë [REDACTED] ka te kryer shkollën fillore, i martuar, prinë i dy fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.
2. [REDACTED], nga fshati [REDACTED] K.Ferizaj, i lindur me [REDACTED] në Prishtinë, nga i ati [REDACTED] dhe e ëma [REDACTED] e gjinisë [REDACTED], ka te

kryer 3 klasë të shkollës fillore, i martuar, prindë i katër fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës

3. [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] K.Ferizaj, i lindur me [REDAKTUAR] në Ferizaj, nga i ati [REDAKTUAR] dhe e ëma [REDAKTUAR] e gjinisë [REDAKTUAR] ka të kryer shkollës e mesme, i martuar, prindë i tre fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr.përsonal [REDAKTUAR]

I

Të akuzuarit [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR]

JANË FAJTOR

Sepse me dt.13.07.2016 rreth orës 23:30 në rrugën " Fatmir Ratkoceri" [REDAKTUAR] në Ferizaj të pandehurit në bashkëkryerje e me qëllim të përvetësimit të sendeve të huaja të luajtshme e që vetit t'i sjellin përfitim pasuror të kundërligjshëm, kanë hyrë në garuzhdën e të dëmtuarit [REDAKTUAR] dhe afër shporetit të nxehjes i kanë marrë një palë puma të markës Supra vlera e tyre është 70 euro, ku të njëjtat pasi janë sekuestruar nga policia i janë kthyer të dëmtuarit,-

Me çka në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale vjedhje nga neni 325 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së,

Andaj gjykata në bazë të neneve 4,7,17,21,41, 46,50,51 dhe 73 të KPRK-së si dhe neni 365 të KPPK-së, i:

GJYKON

1. Të akuzuarin [REDAKTUAR]

DËNIM ME GJOBË NË SHUMË PREJ 300/treqind/ euro të cilin dënim është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 dite nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, si dhe

DËNIM BURGIMI NË KOHËZGJATJE PREJ 3/ tre / muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afatin prej 1/një/viti nga data kur aktgjykimi merr formën e prerë nuk kryen vepër tjetër penale.

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as në mënyra tjera të parapara në nenin 46 të KPRK-së, i njëjti do ti shndërrohet në dënim burgu ashtu që për çdo 20 euro, do ti llogaritet 1(një) ditë burg.

2. Të akuzuarin [REDAKTUAR]

DËNIM ME GJOBË NË SHUMË PREJ 300/treqind/ euro të cilin dënim është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 dite nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

DËNIM BURGIMI NË KOHËZGJATJE PREJ 3/ tre / muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afatin prej 1/një/viti nga data kur aktgjykimi merr formën e prerë nuk kryen vepër tjetër penale.

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as në mënyra tjera të parapara në nenin 46 të KPRK-së, i njëjti do ti shndërrohet në dënim burgu ashtu që për çdo 20 euro, do ti llogaritet 1(një) ditë burg.

I dëmtuari [REDAKTUAR] nga Ferizaj, rr. [REDAKTUAR] për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Obligohen të akuzuarit që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj në mënyrë solidare shumën prej 30 /tridhjetë/ €, si dhe veç e veç shumën prej 30 /tridhjetë/ € për programin për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afatin prej 15 ditësh pasi që aktgjykimi të marr formën e prerë nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

II

Konform nenit 364 pr.1 pika 1.3 të KPPK-së

Të akuzuarit [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR]

LIROHEN NGA AKUZA

Me datën 07.01.2015, në fshatin [REDAKTUAR] Komuna Ferizaj, me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete apo për personin tjetër, duke e përdorur forcën me një mjet të fortë kishin thyer derën e lokalit ushqimor pronë e të dëmtuarit [REDAKTUAR] dhe aty kishin vjedhur gjëra ushqimore, sipas të dëmtuarit dëmi i shkaktuar është rreth 388 euro,

-me që nuk është provuar se të akuzuarit në bashkëkryerje të kenë kryer veprën penale vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 nën par.1.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

I dëmtuari [REDAKTUAR] nga fsh [REDAKTUAR] Komuna Ferizaj për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

III.

Ne kuptim të nenit 363 par.1 pika 1.1 të KPRK-së

Ndaj të akuzuarit [REDACTED]

REFUZOHET AKUZA

Se me datën 12.12.2015 rreth orës 22:10 në fshatin Talinoc i Muhaxherve në Ferizaj, i pandehuri [REDACTED] me qëllim që vetës ti sjelli përfitim pasuror të kundërligjshëm, në atë mënyrë që nga oborri i shtëpisë së [REDACTED] ka marrë 39 copa anësore të betonit të cilat ika bartur me automjetin e markës "Opel Corsa" me targa të regjistrimit [REDACTED], vlera e dëmit nuk është përcaktuar nga i dëmtuari, -

meqë Prokurori i Shtetit në fjalën përfundimtare është tërhequr nga akuza për shkak se me asnjë provë nuk është provuar se ka kryer veprën penale vjedhje nga neni 325 par.1 të KPRK-së.

Shpenzimet sa i përket pjesës II dhe III të këtij aktgjykimi bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj Gjykate.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj, me aktakuzë PP/II.nr.746-1/15 të datës 16 nëntor 2015, ka akuzuar [REDACTED] dhe [REDACTED] që të dy nga fsh [REDACTED] K. Ferizaj për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale vjedhje e rëndë nga neni 327 par. 1 nën par 1.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, me aktakuzën PP/II.nr.1520-7/16 të datës 21 prill 2017 ka akuzuar [REDACTED] dhe [REDACTED] që të dy nga fsh [REDACTED] K. Ferizaj për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale vjedhje nga neni 325 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, me aktakuzën PP/II.nr.1024-4/16 të datës 27.04.2017, ka akuzuar [REDACTED] nga fsh [REDACTED] K.Ferizaj për shkak të veprës penale vjedhje nga neni 325 par. 1 të KPRK-së.

Gjykata sipas detyrës zyrtare konform nenit 35 par. 7 të KPPR-së, me datë 12.10.20147 ka marrë Aktvendimin për Bashkimin e lëndëve P.nr 1422/15 sipas

aktakuzës PP/II.nr.746-1/15 të datës 16 nëntor 2015, P.nr.1057/17 sipas aktakuzës PP/II.nr.1520-7/16 të datës 21 prill 2017, P.nr.1022/17 sipas aktakuzës PP/II.nr.1024-4/16 të datës 27.04.2016, kundër të akuzuarit [REDAKTUAR] nga fsh. [REDAKTUAR] K. Ferizaj për shkak se kemi të bëjmë me të akuzuar të njëjtë dhe të natyrës së njëjte të veprës penale dhe më tutje lënda do të udhëhiqet dhe evidentohet me numër P.nr.1422/15.

Gjykata caktoi dhe mbajti shqyrtimin fillestar me datë 12.10.2017, në të cilën shqyrtim të akuzuarit [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] lidhur me aktakuzën PP/II.nr.1520-7/16 të datës 21 prill 2017 për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale vjedhje nga neni 325 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së janë deklaruar fajtor për veprën penale të cilën i ngarkon akuza, duke shprehur pendim për veprën e kryer, duke shprehur keqardhje, i kërkojnë falje të dëmtuarve, i premtojnë gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsërisin vepra të tilla apo të ngjashme penale, lusin gjykatën që t'iu shqiptoj një dënim sa më të butë.

Ndërsa të pandehurit [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] në shqyrtimin gjyqësor kanë deklaruar se nuk e pranojnë fajësinë sa i përket lidhur me veprën penale vjedhje e rëndë në bashkëkryerje nga neni 327 par/1 nënpar 1.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së sipas aktakuzës PP/II.nr.746-1/15 të datës 16 nëntor 2015, e gjithashtu edhe i pandehuri [REDAKTUAR] ka deklaruar se nuk e pranon fajësinë për veprën penale vjedhje nga neni 325 par.1 të KPRK-së sipas aktakuzës PP/II.nr.1520-7/16 të datës 21 prill 2017.

Prokurori me rastin e paraqitjes së mendimit të tij, ka propozuar që të pranohet pranimi i fajësisë për të akuzuarit [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] lidhur me veprën penale vjedhje në bashkëkryerje nga neni 325 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, sipas aktakuzës PP/II.nr.746-1/15 të datës 16 nëntor 2015 pasi që një pranim i tillë është bërë vullnetarisht nga ana e të akuzuarve dhe të njëjtit ti shpall fajtor dhe ti shqiptohet një dënim i paraparë me ligj.

Mbrojtësi i të akuzuarit [REDAKTUAR] av [REDAKTUAR] ka deklaruar se i mbrojturi i tij ka pranuar fajësinë pas konsultimit të mjaftueshëm dhe të, i propozon gjykatës që pranon pranimin e fajësisë nga i akuzuari.

Pasi që të akuzuarit [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] kanë pranuar fajësinë sipas aktakuzës PP.nr.1520-7/15 e dt.21.04.2017, për veprën penale vjedhje në bashkëkryerje nga neni 325 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë dhe shqyrtoi me kujdes faktet e parapara nga neni 248 par. 1 të KPPK-së dhe me këtë rast vlerësoi se të akuzuarit kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga ana e të akuzuarve, pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit siq janë: vërtetimi mbi sekuestrimin e sendeve i dt.19.07.2017, vërtetimi mbi kthimin e sendeve i dt.19.07.2017, deklarata e vet të pandehurve të dhënë në procedurën hetimore si dhe shkresat e tjera të lëndës.

Meqenëse të akuzuarit kanë pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkuara më lartë, gjykata konform nenit 248 paragrafit 4 të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Duke vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarve ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale në bashkëkryerje vjedhje në tentativë e në vazhdim nga neni 325 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së sikurse me datë, vend dhe kohë siç është përshkruar hollësisht në dispozitivin I të këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarit, Gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPRK-ës dhe gjeti si rrethanë lehtësuese se për të akuzuarin [REDAKTUAR] mori faktin se i akuzuari ka pranuar fajësinë, duke e shprehur pendimin e sinqertë dhe real për veprën penale të kryer, sjelljen korrekte gjatë tërë procedurës, në rastin konkret nuk gjeti ndonjë rrethanë rënduese. Po ashtu edhe për të pandehurin [REDAKTUAR] gjykata si rrethanë lehtësuese mori pranimin e fajësisë, pendimin e shprehur për veprën penale që ka kryer, premtimin se më nuk do të përsërisë veprime të tilla, se i njejtë është i martuar dhe prind i katër fëmijëve, i pa punë, i gjendjes së vështir ekonomike, ndërsa si rrethana rënduese për të akuzuarve gjykata ka vlerësuar

rrethanat në të cilën ka ndodhur ngjarja, po ashtu edhe shkallën e përgjegjesisë penale të akuzuarve si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale.

Gjykata është bindur se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarve është në harmoni me peshën e veprës penale, me shkallën e përgjegjesisë penale të akuzuarve dhe me dënimin e shqiptuar me gjobë dhe dënimin me kusht do të arrihet qëllimi i dënimit siç parashihet në dispozitat e nenit 41 të KPRK-së.

II.

Sa i përket pikës II të këtij aktgjykimi, Gjykata ka bërë paraqitjen e provave dhe pas vlerësimit të tyre një nga një dhe duke i ndërlidhur reciprokisht njëri me tjetrin, në kuptim të dispozitës së nenit 361 par. 1 dhe 2 të KPP-së, vërtetoi gjendjen faktike të përshkruar hollësisht në dispozitën e këtij aktgjykimi.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj çështje penale caktoi dhe mbajti shqyrtimin gjyqësor me datë 23.04.2018, në të cilën shqyrtim përfaqësuesi i akuzës – Prokurori i Shtetit Mimoza Syla, deri në fjalën përfundimtare ka mbetur në tërësi pranë aktakuzës PP.nr.746-1/15 e dt.16.11.2015 për veprën penale në bashkëkryerje vjedhje e rëndë nga neni 237 par.1 nënpar 1.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, pas administrimit të provave gjatë shqyrtimeve gjyqësore të deritanishme vlerësoi se është vërtetuar se të pandehurit [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] kanë kryer veprën penale që janë akuzuar nga prokuroria dhe atë pas administrimit të provës materiale raporti i oficerit fotografitë e vendit të ngjarjes dëgjimi i të dëmtuarit [REDAKTUAR] në cilësinë e dëshmitarit është vërtetuar se të pandehurit në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale si në dispozitivin II të këtij aktgjykimi, andaj i propozon gjykatës që të akuzuarit ti shpall fajtor dhe të njëjtëve ti shqiptoj sanksion penale të paraparë me ligj.

Mbrojtësi i të akuzuarit [REDAKTUAR] av. [REDAKTUAR] në fjalën përfundimtare ka deklaruar se aktakuza përmban parregullsi të shumta dhe me asnjë pronë nuk është vërtetuar se i mbrojturi i tij e ka kryer këtë veprë penale, procesverbalet e hartuar në polici nuk mund të mirren si provë sepse në aktin akuzues dhe as në shqyrtimin gjyqësor

nuk janë propozuar si provë. Deklarata e dhënë në polici konsiderojmë se janë prova të papranueshme sepse janë marrur me përdorimin e dhunës, andaj në mungesë të provave i propozojmë gjykatës që të mbrojturin e tij ta liron nga akuza.

2. Mbrojtja e të akuzuarve

I akuzuari [REDAKTUAR] nga fillim i shqyrtimit gjyqësor e deri në përfundim nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale në fjalë, kurse me rastin e paraqitjes së mbrojtjes së saj ka deklaruar se nuk është e vërtetë që me datën 07.01.2015 ka vjedhur në fshatin [REDAKTUAR] dhe nuk njeh person me emrin [REDAKTUAR] deklaraten në polici e ka dhënë pasi e kanë rrahur policia ndërsa deklaraten në prokurori ka deklaruar njejtë si në deklaraten e sotme.

I akuzuari [REDAKTUAR] nga fillim i shqyrtimit gjyqësor e deri në përfundim nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale në fjalë, kurse me rastin e paraqitjes së mbrojtjes së saj ka deklaruar se qëndron prapa deklaratave të dhënë në polici dhe prokurori në të cilat ka mohuar se e ka kryer këtë veprë penale, nuk njeh person me emrin [REDAKTUAR].

3. Provat e paraqitura në shqyrtim gjyqësor

Pasi që i akuzuari nuk ka pranuar fajësinë sipas pretendimeve të akuzës, Gjykata ka bërë paraqitjen e provave dhe pas vlerësimit të tyre një nga një dhe duke i ndërlidhur reciprokisht njëri me tjetrin, në kuptim të dispozitës së nenit 361 par. 1 dhe 2 të KPP-së, vërtetoi gjendjen faktike të përshkruar hollësisht në dispozitën e këtij aktgjykimi.

Gjykata gjendjen e këtyre faktike e ka vërtetuar përmes provave të prezantuara në shqyrtimin gjyqësor dhe atë:

- mbrojtja e të akuzuarve gjatë shqyrtimit gjyqësor;
- përmes dëgjimit dëshmisë së të dëmtuarit-dëshmitarit [REDAKTUAR]
- përmes leximit të raportit të oficerit me nr.2015-CF-044 i datës 07.01.2015.
- përmes shikimit të 8 fotografive kopje;

- përmes shikimit të librezës së veturës Opel Corsa, tabela të regjistrimit [REDACTED], me nr [REDACTED];
- Përmes leximit të raportit të oficerit me nr.2015-CF-2448 të datës 12.12.2015;
- përmes shikimit në shkresave të lëndës.

4. Vlerësimi i provave të paraqitura në shqyrtimin gjyqësor

Fillimisht Gjykata vlerëson si të vërtetuar dhe të pakontestueshme në aspektin objektiv përkatësisht faktet si në vijim:

- se në fshatin Mirosal, në lokalin pronë e të dëmtuarit [REDACTED] ishin vjedhur gjëra ushqimore në vlerë prej 388 euro.

Andaj në këtë çështje penale ka qenë kontestuese vërtetimi i fakteve për implikimin e të akuzuarit përkatësisht vërtetimi i faktit se a ishin të akuzuarit kryerës të kësaj vepre penale.

Nga përmbajtja e dëshmisë së të dëmtuarit dëshmitarit [REDACTED] vërtetohet se me dt.07.01.2015, në ora 07.00 të mëngjesit kur ka shkuar ta hap lokalin ka vërejtur se dera e lokalit është e thyer dhe lokali është i demoluar. I njëjti ka deklaruar se dera e lokalit ka qenë e mbyllur me 3 dryna dhe qelës, nuk e di se kush e ka kryer vjedhjen dhe të akuzuarit nuk i njeh dhe për herë të parë i ka takuar në sallë të gjyqimit dhe se vlera e mallit të vjedhur është 388 euro.

Përmes provave materiale Gjykata vlerëson se janë prova të besueshme por këto vërtetojnë vetëm aspektin objektiv të kësaj vepre penale se në lokalin – pronë e [REDACTED] janë vjedhur gjëra ushqimore dhe se dera e lokalit ishte thyer por nuk e vërtetojnë dhe nuk sqarojnë asgjë në aspektin subjektiv përkatësisht faktin se kush ishte kryerësi i kësaj vepre penale dhe në asnjë mënyrë nuk provon implikimin e të akuzuarve në kryerjen e kësaj vepre penale.

5. Vlerësimi i mbrojtjes së të akuzuarve

Mbrojtja e të akuzuarit [REDACTED] dhe [REDACTED] në të gjitha fazat e procedurës penale është përqendruar në kundërshtimin e fakteve se kishin kryer këtë veper penale e peshkuar në akuzë por pa paraqitur hollësi dhe detaje për këtë çështje.

Por gjykata tezës së të akuzuarve i besoi për faktet vendimtare të kësaj çështje përkatësisht për vjedhjen meqë kjo mbrojtje është në përputhje të plotë me provat e tjera e po ashtu në rastin konkret skemi asnjë dëshmi që lidhin të akuzuarit me kryerjen e kësaj vepre penale.

6. Analiza e fjalës përfundimtare të Prokurorit të shtetit

Prokurori i Shtetit gjatë fjalës së tij përfundimtare ka mbetur pranë aktakuzës dhe kualifikimit juridik të veprës penale duke propozuar që i akuzuarit të shpallen fajtor dhe të i shqiptohet dënim sipas ligjit, duke përshkruar provat materiale.

Por, në thelb nuk ka arritur që të paraqes ndonjë provë të themeltë që do të bënte të besueshëm se të akuzuarit janë kryerës të kësaj vepre penale, por, shumica e pretendimeve të tij kanë mbetur në suaza të supozimeve, pa arritur që ta tejkalojnë kufirin e dyshimit të arsyeshëm.

Fokusi i fjalës përfundimtare të prokurorit të shtetit mbështetet provat material dhe atë cilat do ti analizojmë më hollësisht disa nga këto pretendime:

- nga raporti i oficerit dhe fotografive në vendin e ngjarjes se të akuzuarit vërtetohet se të akuzuarit janë kryes të veprës penale Gjykata pajtohet se është fakt i pakontestueshëm se dera e lokalit është thyer dhe janë marrë sendet por ky paraqet vetëm aspektin objektiv të kësaj ngjarje dhe jo edhe aspektin subjektiv- personin që ka kryer vjedhjen.

- I panduri [REDAKTUAR], në asnjërën fazë të procedurës penale, as në deklaratën e dhënë në procedurën parakrake në stacionin Policor në Ferizaj me datë 23.04.2015, por as në deklaratën e dhënë para prokurorit të shtetit me datë 13.11.2015, nuk ka pranuar se ka kryer veprën penale si në disozitivin e aktakuzës.

- Ndërsa i pandehuri [REDAKTUAR] në deklaratën e dhënë në stacionin policor në Ferizaj, me datë 21.04.2015, ka pranuar se së bashku me [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] kanë shkuar në fshatin Mirosalë dhe me kaqavidë kanë hapur derën e marketit dhe kanë hyrë brenda dhe kanë marrë gjera ushqimore, mirëpo i njeiti këtë deklaratë e ka mohuar para Prokurorit të shtetit me datë 13.11.2015, e që edhe për

gjykatën këto janë vlerësuar si kontradiktore, pasi që Gjykata me rastin e vendosjes është e obliguar që të provoj të gjitha faktet në mënyrë të gjithanshme dhe të pa kontestueshme, në favor dhe disfavor të akuzuarit, e posaçërisht këtë duke e ndërlidhur me nenin 3 të KPPK-së, *parimin e prezumimit të pafajësisë dhe parimin in dubio pro reo*, se mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të të pandehurit dhe të drejtave të tij sipas këtij Kodi dhe sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, kurse në ndërlidhje të kësaj po ashtu duke pasur parasysh faktin se të gjitha argumentet që janë "*in peius*" ndaj të akuzuarve duhet të vërtetohen me siguri të plotë përkatësisht përtej dyshimit të arsyeshëm (*beyond reasonable doubt*) dhe nëse nuk arrihet një diçka e tillë duhet konsiderohen se nuk ekzistojnë kurse për argumentet që janë "*in favorem*" ndaj të akuzuarit merren se ekzistojnë edhe atëherë kur janë vërtetuar me probabilitet.

Gjykata po ashtu ka aplikuar dispozitën nga neni 262 par.2 të KPP-së, e cila në mënyrë taksative parasheh që gjykata nuk e shpall fajtor duke u mbështetur vetëm në një deklaratë ose duke i dhënë rëndësi vendimtare deklaramit të dhënë nga i pandehuri në polici ose para prokurorit të shtetit, andaj gjykata në rastin konkret nuk ka mundur ti shpallë fajtor të akuzuarit vetëm mbi bazën e një deklarate të pandehurit [REDACTED] të dhënë në stacionin policor, pa pasur mbështetje në provat tjera materiale në të cilat prova gjykata do të mund ta mbështeste një aktgjykim dënues për të pandehurit, e që për më tepër është e pa diskutueshme se mbi kënd bie barra e provës për fajësinë e të akuzuarit dhe çdo veprim tjetër i Gjykatës do të kuptohej si e kundërt dhe në këtë mënyrë lëvizje e barrës së provës nga organi i akuzës në të akuzuarit, e cila është në kundërshtim esencial të njërit prej parimeve fundamentale të procedurës penale e përcaktuar me nenin 7 të KPPK-së dhe e garantuar edhe me nenin 6.2 të KEDLNJ.

Në kuptim të nenit 463 par. 3 të KPP-së, i dëmtuari [REDACTED] për realizimin e kërkesës pasurore – juridike udhëzohet në kontest civil.

Konform nenit 454 par.1 të KPP-ës, shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve të kësaj Gjykate

III.

Sa i përket pjesës së tretë të këtij aktgjykimi përkatësisht pjesës së aktgjykimit refuzues Prokurori i Shtetit, në fjalën përfundimtare është tërhequr nga akuza ndaj të akuzuarit [REDAKTUAR], për shkak të veprës penale vjedhje nga neni 325 par.1 të KPRK-së si akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.1024-4/16 të datës 27.04.2017, meqë nga provat e prezantuara në shqyrtimet gjyqësore të me asnjë provë nuk është vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën penale në fjalë.

Pasi që Prokurori i shtetit është tërhequr nga akuza kundër të pandehurit gjykata në bazë të nen. 363 par.1 nën par.1.1 të KPPK, vendosi si në dispozitiv III të këtij aktgjykimit.

Konform nenit 454 par.1 të KPK -së shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore.

Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
DEPARTAMENTI I PËRGGJITHSHËM
DIVIZIONI PENAL**

P.nr.1422 /15 me datë 02.05.2018

Sekretare juridike,

Drita Ujupi

Gjyqtari,

Mustaf Tahiri



Këshilla juridike: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.